

RAPORT TEMATIK

RESPEKTIMI I KUOTËS SË PUNËSIMIT TË PJESËTARËVE
TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË
INSTITUCIONE PUBLIKE

Korrik, 2019

Dhurata Prokshi

RAPORT TEMATIK

RESPEKTIMI I KUOTËS SË PUNËSIMIT TË PJESËTARËVE TË KOMUNITETEVE
ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË INSTITUCIONE PUBLIKE

Korrik, 2019

The views expressed in this assessment do not necessarily reflect the views of the Regional Cooperation Council or of its participants, nor of the European Union and the Open Society Foundations."

Përmbajtja

1	HYRJE	4
2	Qëllimi i studimit	4
3	Metodologjia e hulumtimit	4
4	Konteksti i përfshirjes së komuniteteve në shoqërinë kosovare	4
5	Sigurimi i të drejtave,qasjes dhe përfshirjes së qytetarëve nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane në tregun e punës	6
6	Gjendja e punësimit të qytetarëve rom,ashkali dhe egjiptian nësektorin publik dhe këndvështrimi nga terreni	6
6.1	Mitrovica	9
6.2	Fushë Kosovë	10
6.3	Ferizaj.....	11
6.4	Gjakovë	12
7	Perspektiva nga terreni për zbatimin e kuotës së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptian	13
8	Përfundim dhe rekomandime.....	18

1 HYRJE

Raporti tematik "Respektimi i kuotës së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në institucione publike" zhvillohet në kuadër të projektit KOSINT 2020. Ky projekt zbatohet nga partneriteti i katër organizatave të shoqërisë civile - Balkan Sunflowers Kosova, Syri i Vizionit, RADC, të udhëhequra nga Qendra Kosovare e Arsimit dhe i përkushtohet gjithëpërfshirjessë pjesëtarëve të komuniteteve rome, ashkali, egjiptiane në fushat e arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale. Financuar nga Roma Initiatives Office (RIO), në kuadër të Fondacionit për Shoqëri të Hapur (OSF), projekti synon përmirësimin e qasjes së komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në arsim, punësim dhe mirëqenie sociale, duke kontribuar në përmbushjen e zotimeve të Qeverisë së Kosovës përmes inkurajimit të pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e reformave sektoriale, në zhvillimin e politikave dhe planifikimit buxhetor si dhe në avokim. Raporti tematik përbëhet nga tri pjesë: 1) Korniza ligjore që siguron përfshirjen e komuniteteve në shoqërinë kosovare, 2) Konteksti i përfshirjes së komuniteteve në shoqërinë kosovare, 3) Perspektiva nga terreni për përfshirjen e komuniteteve në punësim - lidhur me këtë çështje me ne kanë ndarë këndvështrimin e tyre qytetarë, aktivistë nga shoqëria civile, përfaqësues institucionesh dhe biznesesh, si dhe pjesa 4) Përfundim dhe rekomandime.

2 Qëllimi i studimit

Në kuadër të raportit "Respektimi i kuotës së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në institucione publike", është realizuar studim për matjen e zbatimit të kuotës së punësimit tek komunitetet pakicë në vend me qëllim që të vlerësohet zbatimi i saj tek punësueshmëria e komuniteteve të shënjestruar rome, ashkali dhe egjiptian në nivelin qendror e lokal. Raporti ka zgjedhur për mostër katër

komuna, atë të Mitrovicës, Fushë Kosovës, Ferizajt dhe Gjakovës.

Hulumtimi i zhvilluar ka pasur për qëllim që të sjellë këndvështrimin, zërin e komuniteteve për gjendjen e tyre në punësim. Njëkohësisht, të gjeturat dhe rekomandimet e këtij raporti do të shërbejnë si mjet avokues, thirrje për sensibilizimin e akterëve institucionale e joqeveritarë të nivelit lokal e qendrorë që të angazhohen në përmirësimin e gjendjes së punësimit të komuniteteve, si një e drejtë e patjetërsueshme e njeriut dhe obligim ligjor e kushtetues.

3 Metodologjia e hulumtimit

Procesi i zhvillimit të hulumtimit dhe hartimit të raportit ka pasur në dispozicion periudhën kohore maj-qershor 2019 për realizim.

Qëllimi i hulumtimit ka qenë nxjerrja e informacioneve cilësore nga terreni mbi temën për punësimin e komuniteteve prandaj edhe janë zhvilluar intervista gjysmë të strukturuar. Intervistat janë zhvilluar me pjesëtarë të këtyre komuniteteve, përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarë nga Zyrat për komunitete dhe kthim, Zyratepunësimit, Aleancës kosovare të biznesit.

Hulumtimi është shtrirë në katër komuna - Gjakovë, Mitrovicë, Fushë Kosovë dhe Ferizaj, të cilat kanë dallime në kontekstin e përfshirjes së komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në shoqërinë kosovare.

4 Konteksti i përfshirjes së komuniteteve në shoqërinë kosovare

Me qëllim të harmonizimit të legjislacionit dhe politikave vendore me ato evropiane për të drejtat e njeriut dhe përfshirjen e grupeve të marginalizuara etnike, Kosova poashtu ka krijuar mekanizma dhe ka hartuar dokumente

me qëllim të këtij përafrimi programor. Zhvillimin e një qasje të tillë, përfaqësuesit e institucioneve vendore e trashëgjuan nga periudha e administrimit të vendit nga Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara, e cila i kishte vënë bazat e respektimit të diversitetit kulturor si vlerë në vend. Me këtë rast u krijuan institucione që do të merreshin me tema të caktuara në veçanti, sikurse që është rasti me komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane. Nevoja që të trajtohen këto komunitete me një përkushtim të veçantë, të paktën në aspekt ligjor,

rrjedh nga gjendja e tyre e pafavorshme në shoqërinë kosovare, ndërsa numri i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve poashtu është i lartë. Nga regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë rezultojnë të jenë 1,739,825 banorë, prej tyre 15,436 ashkali, 11,524 egjiptianë dhe 8,824 romë. Të dhënat nga regjistrimi i fundit i vitit 2011 në Kosovë nuk janë të plota për shkak të mos përfshirjes në regjistrim të komunave ku shumica e popullatës është serbe. Në tabelë më poshtë është paraqitur shtrirja e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane sipas komunave:

Komuna	Romë	Ashkali	Egjiptianë	Gjithsej
Deçan	33	42	393	468
Gjakovë	738	613	5,117	6,468
Glllogoc	0	0	2	2
Gjilan	361	15	1	377
Dragash	3	4	3	10
Istog	39	111	1,544	1,694
Kaçanik	5	1	0	6
Klinë	78	85	934	1,097
Fushë Kosovë	436	3,230	282	3,948
Kamenicë	240	0	0	240
Mitrovicë	528	647	6	1,181
Lipjan	342	1,812	4	2,158
Novobërdë	63	3	0	66
Obiliq	661	578	27	1,266
Rahovec	84	404	299	787
Pejë	993	143	2,700	3,836
Podujevë	74	680	2	756
Prishtinë	56	557	8	621
Prizren	2,899	1,350	168	4,417
Skenderaj	0	10	1	11
Shtime	23	750	0	773
Shtërpçë	24	1	0	25
Suharekë	41	493	5	539
Ferizaj	204	3,629	24	3,857
Viti	12	14	0	26
Vushtrri	68	143	1	212
Malishevë	26	5	0	31
Mamushë	39	12	0	51
Graçanicë	745	104	3	852
Klllokot	9	0	0	9
Gjithsej	8,824	15,436	11,524	35,784

Tabela 1. Pjesëtarët e komuniteteve ashkali, egjiptiane dhe rome sipas komunave në Kosovë¹

¹ Tabela.1 ASKDATA <http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/?rxid=0b4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712/>

5 Sigurimi i të drejtave, qasjes dhe përfshirjes së qytetarëve nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane në tregun e punës

Trajtimi i barabartë dhe respektimi i të drejtave të të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallime etnike bazën e ka në Kushtetutën e Kosovës, e cila si akti më i lartë juridik i shtetit ka rregulluar të drejtat e qytetarëve në përputhje me Konventat ndërkombëtare të drejtave të njeriut². Mbi një bazë të tillë juridike janë hartuar edhe ligjet të cilat garantojnë të drejtat e të gjithë qytetarëve. Legjislacioni dhe strategjitë të cilat në mënyrë specifike trajtojnë përfshirjen e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane janë:

1. Ligji Kundër Diskriminimit
2. Ligji për Shërbyesit Civil
3. Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane 2017/2021 dhe 2009/2015
4. Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2017/2021, 2011/2016

Përkushtimi i institucioneve vendore që të punojnë për promovimin e të drejtave të njeriut dhe luftën kundër diskriminimit të komuniteteve pakicë në vendështë shfaqur edhe me krijimin e mekanizmave që fushëveprimin e tyre e kanë në nivelin qendror e atë lokal. Mekanizmat me të cilën është mëtuar të adresohet respektimi i të drejtave të komuniteteve janë:

- **Zyra për qeverisje të mirë (ZQM)**
- **Këshilli konsultativ për komunitetet**

- **Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimit**
- **Zyra për çështjet e komuniteteve (ZÇK)**
- **Zyra e Komisionarit për Gjuhët**
- **Komunat**
- **Zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK)**
- **Komiteti komunal për komunitete**

6 Gjendja e punësimit të qytetarëve rom, ashkali dhe egjiptianë në sektorin publik dhe këndvështrimi nga terreni

Ministria e Administratës, si institucioni më i lartë i administratës në vend, në raportet e saj të rregullta për gjendjen e të punësuarve në nivel qendror dhe atë lokal, ofron të dhëna të rregullta ku shohim edhe gjendjen e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Me qëllim të vlerësimit të zbatimit të kuotës së punësimit për komunitete prej 10% në sektorin publik "*Në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror minimum 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilët u përkasin komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret specifike të punësimit. Në nivelin komunal për anëtarët e kualifikuar të komuniteteve që nuk janë shumicë në komunë, do të jetë i rezervuar numri i vendeve të punës në pajtim me përfaqësimin procentual të komuniteteve të komunës së dhënë*"³

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, kapitulli II

³ LIGJI NR. 03/L-149 PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS <https://qzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2679>

e paraparë me Ligjit 03/L-149 mbi Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës. Më poshtë do të paraqesim gjendjen e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për periudhën 2017/2018 në nivel qendror dhe 2016/2017 dhe 2018 për nivelin lokal në komunat - Mitrovicë, Ferizaj, Fushë Kosovë dhe Gjakovë.

Gjatë vitit 2018, nga 56 institucione të nivelit qendror që numëronin **30,635** të punësuar në shërbimin publik, nga ky numër vetëm 113 prej tyre rezultojnë të jenë pjesëtarë të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane dhe atë të punësuar vetëm në 10 prej këtyre institucioneve.

Nr.	Institucioni	Nr. i përgjithshëm i të punësuarve	Ashkali	Egjiptianë	Romë
1.	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor	525		1	
2.	Ministria e Shëndetësisë	7723	3	12	19
3.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	771			1
4.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1496		1	3
5.	Ministria e Financave	1064			1
6.	Ministria e Drejtësisë	1862	1		9
7.	Ministria e Punëve të Brendshme	1894		1	3
8.	Policia e Kosovës	8680	19	8	16
9.	Dogana e Kosovës	583	2	3	3
10.	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1097	1	2	2

Tabela 2. Gjendja e punësimit të komuniteteve në nivel qendror për vitin 2018⁴

Ndërsa nëse shikojmë gjendjen e punësimit të komuniteteve në vitin 2017e

vërejmë se dallimi është simbolik me një trend të lehtë pozitiv në vitin 2018 në

⁴ Tabela 2. Raporti Gjendja e punësimit të komuniteteve në nivel qendror për vitin 2018 i Ministrisë së Administratës Publike <https://map.rks-gov.net/page.aspx?id=1,49>

kuptimin e ngritjes së numrit të të punësuarve nga radhët e komuniteteve. Përkundër hapësirës që iu krijua partive politike nga radhët e komuniteteve që të jenë pjesë e qeverisjes aktuale,

duke marrë gjashtë pozita për zëvendësministra, një hap i tillë politik nuk u përcjellë me hapjen e perspektivës së punësimit në sektorin publik sikurse që mund të konkludojmë nga numri i të punësuarve në institucione e agjenci të nivelit qendrorë.

Nr	Institucioni	Nr. i përgjithshëm i të punësuarve	Ashkali	Egjiptianë	Romë
1.	Ministria e Shëndetësisë	7695	3	11	15
2.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	775		1	
3.	Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal	260		1	
4.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1032			3
5.	Ministria e Financave	1031			1
6.	Ministria e Drejtësisë	1850	1		9
7	Ministria e Punëve të Brendshme	1894		1	3
8.	Policia e Kosovës	8743	19	8	16
9.	Avokati i Popullit	48	1		
10.	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1574	2		7
11.	Ndihmë Juridike Falas	26		1	
12	Agjencia Kosovaree Pronës	198			1

Tabela 3. Gjendja e punësimit të komuniteteve në nivel qendror për vitin 2017⁵

⁵Tabela 3. Gjendja e punësimit të komuniteteve në nivel qendror për vitin 2017 <https://map.rks-gov.net/page.aspx?id=1,49>

Përderisa në komunat të cilat i kemishënjestruar për vlerësimin e zbatimit të kuotës për përfshirjen e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane për periudhën 2016/2017/2018, vërejmë që gjendja e punësimit të komuniteteve nuk ka pasur ndryshime, që mund të cilësohet si trend negativ. Nga komunat e përzgjedhura - Gjakova, Ferizaj, Fushë

Kosova dhe Mitrovica, kjo e fundit rezultojnë ta ketë gjendjen më të rëndë duke mos pasur të punësuar asnjë pjesëtar të komuniteteve në shërbim publik. Pasqyrat tabelare reflektojnë gjendjen e punësimit në administratë të komunës, arsim dhe shëndetësi si tre sektorët që në shërbimin publik në nivel lokal kanë numrin më të madh të punëtorëve.

6.1 Mitrovica

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, në komunën e Mitrovicës jetojnë 71,909 banorë, ku prej tyre janë 528 (0.73%) romë, 647 (0.90%) ashkali dhe 6 (0.01%) egjiptianë. Këto komunitete jetojnë kryesisht në zonën urbane të qytetit. Komuniteti ashkali është i koncentruar më shumë në lagjen "2 Korriku", ndërsa ai rom në lagjen "Adem Voca"⁶. Sikurse që mund të shihet edhe nga të dhënat zyrtare mbi punësimin e pjesëtarëve të këtyre dy komuniteteve në sektorin publik, përfshirja e tyre në institucione në Mitrovicë është zero. Fakt brengosës në këtë aspekt është që këto komunitete pas vitit 2016, me rastin e lëshimit të vendit të punës në Zyrën për komunitete dhe kthim nga ana e pjesëtarëve të komunitetit rom, marrja e vendit të punës është bërë nga anëtarët e komuniteteve tjera pakicë gjë që e ka dëmtuar përfaqësimin e këtyre komuniteteve në institucionet lokale.

Faktorët e një gjendje të tillë të këtyre dy komuniteteve në komunën e Mitrovicës dalin të jenë: Organizimi i dobët i komuniteteve, mungesa e përfaqësimit dhe përfshirjes së tyre politike në strukturat lokale qeverisëse, mungesa e deritashme e vullnetit politik që të krijohet hapësirë për punësimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, mungesa e presionit ndërkombëtar për përfshirjen e këtyre komuniteteve në punësim. Nga ana e institucioneve të vendit, në parashtrimin e pyetjes mbi punësimin ekëtyre komuniteteve në institucione, është përgjigja e përgjithshme që pjesëtarët e këtyre komuniteteve nuk janë të shkolluar apo nuk kanë kualifikim adekuat, gjendjekjo e cila ka ndryshuar në vitet e fundit, falë përkrahjes me bursa nga ana e organizatave dhe fondacioneve që kanë në fokus punën me komunitete.

Viti	Administratë			Arsim		Shëndetësi	
	Gjithsej	A	R	Gjithsej	Komunitete	Gjithsej	Komunitetet
2018	298	0	0	1225	0	271	0
2017	349	0	0	1216	0	256	0
2016	366	1	1	1216	0	280	0

Tabela. 4. Gjendja e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve në komunën e Mitrovicës

⁶Regjistrimi i popullsisë në Kosovë 2011

6.2 Fushë Kosovë

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, në Komunën e Fushë Kosovës jetojnë 34,827 banorë, ku prej tyre 436 (1.25%) janë romë, 3,230 (9.27%) ashkali, dhe 282 (0.81%) egjiptianë.⁸ Nga të tri komunitetet, komuniteti ashkali përbën shumicën. Niveli i papunësisë në mesin e komuniteteve të kësaj komune është mjaft i lartë. Shkaktarë që kontribuojnë në nivelin e lartë të papunësisë së komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane janë kualifikimet universitare, të cilat paraqiten edhe si kritere kyçe për punësim në sektorin publik.

Një arsye tjetër e cila i ka kontribuar numrit të vogël të punësuarve nga këto komunitete në sektorin publik është moszbatimi i kuotës në mënyrë proporcionale në raport me numrin e të punësuarve të komuniteteve tjera pakicë në këtë komunë. Hartimi dhe aprovimi i Planit Lokal të Veprimit për përfshirje të komuniteteve 2018-2021, nuk ka pasur ndikim në promovimin e punësimit të komuniteteve në këtë komunë.

Viti	Administratë				Arsim				Shëndetësi			
	Gjithsej	A	E	R	Gjithsej	A	E	R	Gjithsej	A	E	R
2018	116	1	1	0	468	0	0	2	105	0	1	0
2017	115	0	1	1	468	0	0	2	105	0	1	0
2016	145	3	0	2	447	0	0	2	104	1	0	0

Tabela 5. Gjendja e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve në komunën e Fushë Kosovës⁷

⁷Tabela 5. Gjendja e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve në komunën e Fushë Kosovës
<https://map.rks-gov.net/page.aspx?id=1,49>

⁸Regjistrimi i popullsisë në Kosovë 2011

6.3 Ferizaj

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në Komunën e Ferizajt jetojnë 108,610 banorë, ku prej tyre 204 (0.19%) janë romë, 3,629 (3.34%) ashkali, dhe 24 (0.02%) egjiptianë. Nga të tri komunitetet, komuniteti ashkali përbën shumicën.⁹

Pjesëtarët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në këtë komunë banojnë kryesisht në zonë urbane dhe tre fshatra (Dubravë, Zaskok, Koshare). Komuna e Ferizajt ka numrin më të madh të zyrtarëve të Zyrës për komunitete në vend,

megjithatë përkundër faktit që kjo komunë ka aprovuar Planin e hartuar strategjik për përfshirjen e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale është vështirë të thuhet që kjo Komunë ka qenë e përkushtuar në zbatimin e kësaj politike. Një përparësi e kësaj Komune në raport me komunat e tjera mund të vlerësohet punësimi i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve me kontrata mbi vepër, praktikë e cila haset rrallë si praktikë në komunat tjera ku banon numër i madh i komuniteteve.

Viti	Administratë				Arsim				Shëndetësi			
	Gjithsej	A	E	R	Gjithsej	A	E	R	Gjithsej	A	E	R
2018	300	6	1	0	1747	5	1		308	0		2
2017	301	6	0	1	1730	5	1		308	0	1	1
2016	249	9	0	3	1817	5	0	1	308	0	0	2

Tabela 6. Gjendja e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve në K. e Ferizajt¹⁰

⁹Regjistrimi i popullsisë në Kosovë 2011

¹⁰Tabela 6. Gjendja e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve në komunën e

Ferizajt <https://map.rks-gov.net/page.aspx?id=1,49>

6.4 Gjakovë

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, në komunën e Gjakovës jetojnë 94,556 banorë, ku prej tyre 738 (0.78%) janë romë, 613 (0.65%) ashkali dhe 5,117 (5.41%) egjiptianë. Nga të tri komunitet, komuniteti egjiptian përbën shumicën.¹² Ajo çfarë e dallon komunën e Gjakovës, respektivisht pozitën e komuniteteve në këtë komunë është përfshirja e madhe dhe organizimi më i mirë i shoqërisë civile, medias dhe Zyrës për komunitete dhe kthim e cila punon në mënyrë konsistente, profesionale dhe të hapur me të gjithë akterët institucional - lokal e qendror, gjë e cila ka ndikuar në mirëqenien e komuniteteve në këtë komunë. Megjithatë, edhe kjo komunë ka sfidat e saj në integrimin e banorëve të lagjeve në periferi të qytetit, ku bëhet

kthimi i vazhdueshëm i të emigruarve në Evropë dhe atyre në Mal të Zi, e që nevojat e tyre të integritit janë të natyrave të ndryshme duke filluar me dokumentacion, strehim, mungesë e njohjes së gjuhës, mungesë e shkollimit, etj. Komuna e Gjakovës ka të hartuara dhe të aprovuara politika të cilat shënjestrojnë përfshirjen e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në shoqërinë kosovare. Zbatimi i këtyre politike lokale arrin të bëhet falë posedimit të buxhetit të saj nga Zyra për komunitete dhe kthim, bashkëpunimit me sektorë tjerë të komunës dhe organizatave donatore.

Viti	Administratë				Arsim				Shëndetësi			
	Gjithsej	A	E	R	Gjithsej	A	E	R	Gjithsej	A	E	R
2018	213		5	0	1051	8	11	7	347	0	0	0
2017	213	0	5	0	1501	8	11	7	347	0	0	0
2016	223	0	5	0	1216	0	0	0	280	0	0	0

Fig. 7. Gjendja e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve në komunën e Gjakovës¹¹

¹¹Tabela 7. Gjendja e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve në komunën e

Gjakovës <https://map.rks-gov.net/page.aspx?id=1,49>

¹²Regjistrimi i popullsisë në Kosovë 2011

7 Perspektiva nga terreni për zbatimin e kuotës së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Me qëllim të krijimit të një pasqyrë më të plotë të zbatimit të kuotës së punësimit dhe gjendjes së punësimit të komuniteteve në komunat e përzgjedhura, janë realizuar intervista të thella me përfaqësues të institucioneve, organizatave të shoqërisë civile të cilat merren me çështje të komuniteteve, aktivistë dhe qytetarë të cilët kanë ndarë opinionet e tyre mbi pyetjet e parashtruara.

1. Sa është e rëndësishme kuota e punësimit për punësimin e komuniteteve, me theks të veçantë atyre rome, ashkali dhe egjiptiane?

Kuotën e punësimit për komunitete në shërbim civil në nivel lokal e qendror të vendit e kanë vlerësuar lartë të gjithë të intervistuarit, ku është cilësuar si mundësi për vënien e baraspeshës së punësimit të komuniteteve në raport me qytetarët e tjerë. **"Kuota është shumë e rëndësishme për komunitete sepse e kanë shumë të vështirë punësimin"** shprehet njëri nga të intervistuarit, ndërsa të intervistuarit vënë në pah edhe keqpërdorimin e kuotës nga komunitetet tjera si element që i zbeh rëndësinë kësaj kuote **"Unë dëshiroj që kuota të shfrytëzohet nga komunitetet dhe jo të shfrytëzohen nga ndonjë komunitet tjetër, siç ka ndodhur dhe është duke ndodhur"**. Problematikë tjetër e cila është shfaqur edhe në këtë hulumtim, kur është shtruar pyetja për rëndësinë e ekzistimit të kuotës, është theksuar shfrytëzimi jo proporcional me komunitetet tjera, siç shprehet edhe njëri nga të intervistuarit tanë në hulumtim,

"Kuota është shumë e rëndësishme por e mbingarkuar me komunitetin serb. Partitë politike duhet të avokojnë që të zbatohet kuota për punësimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian". Një qëndrim i tillë shfaq fuqinë politike që komunitetet e caktuara pakicë kanë në Kosovë, gjë që ndikon edhe në prioritizimin e kërkesave dhe nevojave të tyre në raport me komunitetet tjera në vend.

2. Sa zbatohet kuota për punësim të komuniteteve në institucione publike në komunën tuaj?

Të intervistuarit shprehen të pakënaqur me zbatimin e deritashëm të kuotës, duke potencuar që ajo fare nuk zbatohet apo zbatohet në mënyrë simbolike. **"Në nivel lokal mungon vullneti politik për punësimin e këtyre komuniteteve. Konkursët janë të montuara,"** shprehet njëri nga të intervistuarit. Ajo çfarë shpesh ofrohet nga institucionet lokale si informacion kur raportojnë për numrin e të punësuarve është ngatërrimi i pozitave politikeme ato të shërbyesve civil.

Nëse shohim nga afër shtrirjen e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve në nivel komunash, në rast se ai punësim ekziston, do t'i gjejmë të punësuar në Zyrat për komunitete dhe kthim, por jo edhe drejtoritë e tjera brenda komune apo jashtë saj, në arsim, shëndetësi apo në ndonjë sektor tjetër publik.

3. Ku qëndron sukcesi dhe sfidat në zbatimin e kuotës?

Sukcesi dhe sfida në zbatimin e kuotës së punësimit për pjesëtarët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane, ka perspektiva të ndryshme, varësisht nëse për zbatimin e saj dëgjojmë të flasin zyrtarë nga institucionet apo shoqëria civile. Ekzistimi i një mase të tillë ligjore për mundësimin e promovimit të drejtave në punësim të komuniteteve pakicë në vend shihet si çelës për ngritjen e

mirëqenies së komuniteteve. Sfidat në zbatimin e saj, të intervistuarit i kanë ndërlidhur me shkollimin, ku kemi qëndrime që ky problem është tejkaluar duke pohuar faktin se janë **"Mbi 300 të diplomuar nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane. Balancimi nuk referohet as nuk arsyetohet në mungesë të shkollimit tani"**, dhe përvojën nga aplikimi për konkurse të shpallura **"Shpesh kur individë nga këto komunitete kanë aplikuar për vende pune në sektorin publik, edhe pse kanë qenë kuadro të mirëfillta dhe profesionale në profesionet e kërkuara, megjithatë pa rezultat dhe prapë institucionet lokale na akuzojnë për mungesë të kuadrove"**, mendimin që shkollimi është sfidë në zbatim të kuotës, por paraqet problem vet gjendja e përgjithshme e papunësisë në vend e shpreh njëri nga të intervistuarit duke thënë se **"Çështja e punësimit është problematike për të gjithë. Gjendja ekonomike është e keqe, kualifikimi joadekuat dhe mungesa e profesionalizmit ndikon në mos punësimin e komuniteteve"**. Faktori politik është identifikuar nga të intervistuarit e këtij hulumtimi si sfidë e cila e pengon zbatimin e kuotës, qoftë edhe si pasojë e përçarjeve politike ndërmjet tri komuniteteve. **"Kuota për punësimin e të rinjve në komunën e Ferizajt zbatohet shumë pak pasi që partitë politike e luajnë rolin e tyre"**, në mes partive të ndryshme brenda të njëjtit komunitet. **"Sfidë në punësim është moszbatimi i ligjeve dhe politikave, poashtu gara ndërmjet dy partive të komuniteteve"**, apo mungesa e përfaqësimit politik në institucione lokale duke u shprehur se **"Subjektet politike të komuniteteve në Mitrovicë janë aktive, mungesa e përfaqësimit politik mangësi e madhe"**. Ndërsa për të tjerë sfidë për zbatimin e kuotës për komunitete paraqet mungesa e përfshirjes së faktorit ndërkombëtar në këtë proces **"Mungesa e presionit nga faktori ndërkombëtar**

për zbatimin e politikave që targetojnë përfshirjen e komuniteteve reflektohet" por edhemungesa e iniciativave të iniciuara nga mekanizma përkatës e politikanë që të kërkohet zbatimi i kuotës së punësimit, duke u shprehur **"Nuk ka pasur shtytje/ iniciativa që të potencohet kjo çështje, në 3-4 vitet e fundit mu inicu si çështje nga deputetët, Këshilli konsultativ për komunitete, zv.ministra"**.

Në cilin sektor publik janë të punësuar numri më i madh nga radhët e komuniteteve?

Përfshirja e partive nga radhët e komuniteteve në koalicionin aktual qeverisës nuk prodhohet rezultate në ndryshimin e gjendjes së punësimit të komuniteteve në nivelin lokal. Me përjashtim të disa kontratave mbi vepër të arritura nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve në komunën e Ferizajt. Numri më i madh i të punësuarve nga radhët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane siç pohojnë të intervistuarit nga komuna të ndryshme janë të punësuar në shërbime, respektivisht në kompanitë e mirëmbajtjeve në qytetet ku u zhvillua hulumtimi: **"Komunitete janë kryesisht të punësuar në shërbime. Numri më i madh është në N.P. Qabrati"**. **"Nga radhët e komuniteteve në komunën e Ferizajt, në sektorin publik, më së shumti të punësuar ka në sektorin e pastërtisë nga tri komunitetet"**. **"Pjesëtarët e këtyre komuniteteve janë kryesisht të punësuar në sektorin e mirëmbajtjes dhe higjienës së objekteve dhe hapësirave publike, ndërsa numër më i vogël i tyre janë të punësuar si zyrtarë në strukturën administrative të Komunës"**.

Çfarë masa do të duhej të ndërmerrete shteti që të përmirësonte punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane?

Nga qytetarët e intervistuar, masat që duhet ndërmarrë nga shteti për punësimin e komuniteteve u thanë të jenë shumë dhe si të tilla edhe shumëdimensionale dhe tejet përmbajtjesore, duke filluar me kërkesën që **"Shteti duhet të ndërtohet mbi baza demokratike ku komunitetet trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, përndryshe si shtet atëherë do të krijojmë komunitete që nuk do të kenë mundësinë të kontribuojnë në shtet dhe do të jenë problem në të ardhmen"**, prandaj **"Institucionet duhet të respektojnë me përpikëri obligimet e marra ligjore me ligjet e aprovuara, të krijojnë kushte të barabarta për punësimin e çdo qytetari/je në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet"**.

Duke filluar kështu që të punoj në përfshirjen e komuniteteve, dhe ndryshimet e mendësisë diskriminuese që nga bankat shkollore, meç'rast u tha: **"Shteti duhet me krijë kushte më të mira së pari të çështja e shkollimit ku mësimdhënësit nuk i diskriminojnë fëmijët si të vegjël dhe të mos lejohet të fitohet një frymë indiferente"**, në mënyrë që me edukimin dhe formimin brezave të rinj të drejtën në edukim profesional dhe përgatitjen e kuadrove mostë paraqes sfidë në të ardhmen sikurse tani, ku bëhet kërkesë si vijon **"Të hapen shkolla për të rritur, të përfshihen në mësim të zanateve, t'u jepet mundësi të aplikojnë me projekte, të punësohen në markete dhe profile të ndërtimtarisë"**.

Në mënyrë që të kuptohet gjendja reale e të punësuarve në shërbimin civil të vendit njëra nga të intervistuarat kërkon që **"Fillimisht të bëhet një hulumtim nëpër institucione dhe të dihet numri i saktë i të punësuarve nga radhët e komuniteteve dhe pastaj të ndërmerren hapa konkret të plotësohen këto kuota dhe të**

punësohen pjesëtarët e komuniteteve, në të kundërtën të hiqet pasi që nuk respektohet". Një hulumtim i tillë do ta përcaktonte qartë se cila duhet të jetë agjenda e shoqërisë civile dhe mekanizmave institucionalpër adresimin e çështjes së zbatimit të kuotës dhe parandalimit të keqpërdorimit të saj nga komunitete që nuk u përkasin këtyre grupeve etnike, sikurse që shpreh brengën për këtë fenomen njëri nga të anketuarit: **"Shteti të përkushtohet në zbatimin e kësaj norme ligjore dhe të ndikojë në monitorimin e punësimit dhe mos shkeljen e saj nga qytetarë që nuk u takojnë këtyre komuniteteve, pasi që ka raste kur edhe punësohen në emër të komunitetit duke mos qenë komunitet"**.

Në vend mungon një hulumtim mbi nevojat e tregut të punës dhe profesionet/arsimin, të cilat janë më të kërkuara dhe sigurojnë përfshirjen etë gjithë qytetarëve në tregun e punës, përfshirë qytetarët romë, ashkali dhe egjiptianë. Mungesa e një plani strategjik të punësimit dhe identifikimit të nevojave të tregut të punës në pesë apo dhjetë vjetët e ardhshme, ngjall dëshirën e komuniteteve për migrim jashtë vendi dhe dekurajon të rinjtë e të rejtat e të gjitha komuniteteve, përfshirë ato nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, që të mos e vazhdojnë shkollimin. Një qasje që dekurajon familjet e komuniteteve që nuk kanë statusin e të rikthyerit është pikërisht fokusi i programeve për riintegrimin e tyre në shoqëri, gjë e cila i mllëfos dhe i bën skeptik mbi vendimin e tyre për mos migruar jashtë vendi, qoftë si mungesë e mundësive apo vendim i vullnetit të lirë.

Sa gjejnë hapësirë për punësim në sektorin privat?

Përfshirja e pjesëtarëve romë, ashkali dhe egjiptianë në tregun e punës në sektorin privat, përmes Masave Aktive të Tregut të Punës¹³ është ndër format më të shpeshta të përfshirjes së tyre në punësim e që si proces udhëhiqet nga Zyrat rajonale të punësimit në bashkëpunim me organizata e agjenci ndërkombëtare zhvillimore. Ky proces i ka faktorët e tij të ndikimit në secilën nga komunat ku është zhvilluar hulumtimi, përderisa në komunën e Gjakovës është arritur që të krijohet bashkëpunim i mirëfilltë i Zyrës së punësimit me Zyrën për komunitete dhe kthim, duke arritur të kenë 14 të punësuar të rregullt nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane, ndërsa tre me anë të Masave Aktive të Tregut të Punës. Një bashkëpunim i tillë ka ndikuar që në këtë qytet të krijohet komunitete të bizneseve të cilat udhëhiqen nga pjesëtarë të komuniteteve, si të tilla paraqesin fuqi ekonomike dhe potencial për pranimin e punëtorëve, praktikantëve që janë nga përfitues të skemave të Masave Aktive të Tregut të Punës.

Për dallim nga komuniteti i biznesit në Gjakovë, që është i hapur dhe mirëpret punëtorë që i përkasin këtyre komuniteteve, një mundësi të tillë nuk e kanë punëkërkuuesit nga komunat si ajo e Mitrovicës, Fushë Kosovës dhe Ferizajt, gjë të cilën e konfirmojnë përfaqësuesit e shoqërisë civile, aktivistët dhe përfaqësuesit e institucioneve në përgjigjen e tyre lidhur me këtë pyetje, duke thënë se:

"Komunitetet janë më të punësuarat në sektorin privat, mirëpo kushtet e punës nuk janë si duhet si për të gjithë komunitete tjera"; "Sa i përket sektorit privat është paksa më i theksuar nga të rinjtë të cilët punojnë punë të rënda fizike. Ashtu si e kam përmendur më lartë, pjesëtarët e këtij komuniteti nuk

janë të punësuar nëpër biznese/firma private. Punën e tyre e bëjnë vetëm tek individë të caktuar që u nevojitet për kryerjen e nevojave shtëpiake"; "Punësimi i pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane nuk është njëjtë si për pjesëtarët e komuniteteve tjera. Këto komunitete kanë më shumë sfida. Në sektorin privat ka paragjykime për kulturën e tyre dhe mentalitetin".

Qëndrime të tilla dëshmojnë që kushtet e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane në sektorin privat janë të karakterit të diskriminimit indirekt i cili ndikon në marginalizimin e këtyre komuniteteve në shoqëri. Elementet e tilla janë pasqyrë e stagnimit të zhvillimit të demokracisë në vend.

Si e vlerësoni ndikimin e skemës sociale në (mos) punësim të qytetarëve që vijnë nga këto komunitete?

Skema sociale është faktor shkak-pasojë në shoqërinë tonë për formën dhe kriteret e saj të aplikimit. Si e tillë kritikohet që të ketë nxitur familjet nga radhët e komuniteteve që të ngritin numrin e lindjeve të fëmijëve në mënyrë që taplotësojnë kriterin e përfitimit të kësaj ndihme. Pasiguria në punë, në rastet e punësimit, pagat e ulëta dhe mundësitë e vogla për të gjetur punë në sektorin privat, poashtu janë radhitur një ndër faktorët që familjet që vijnë nga këto komunitete i bënë numrin më të madh të tyre përfitues të skemës sociale. Kjo përvojë ndahet nga të gjithë akterët dhe qytetarët në vend, të cilët shprehin: **"Skema sociale ndikon në masë të caktuar për punësim, por kjo kur është fjala për vend të punës me paga të ulëta".**

¹³ Rr.(MPMS) Nr.01/2018 Për masat aktive të tregut të punës <https://gzk.rks->

"Ndërsa sa i përket skemës sociale mendoj se po i bën familjet e varura nga dita në ditë për shkak se nuk është punuar shumë që t'i kthejnë nga skema sociale në punësim. Shumica e komuniteteve që marrin ndihmë sociale nuk punojnë nga frika se mos po u ndalet skema sociale, por nuk kanë punë të sigurt me kohëzgjatje, sepse puna që ata e bëjnë është më shumë sezonale"
"Në rast të përcaktimit për punë do t'u hiqej ndihma sociale dhe nuk do

të mund të merreshin me aktivitete tjera të cilat u sjellin të ardhura shtesë sikurse që është mbledhja e materialeve, gjësendeve të dorës së dytë apo të përdorura."

Në mënyrë që situatatë ndryshojë, sugjerohet që shteti të ndërmerr hapa konkret në përmirësimin e të drejtave dhe kushteve të punës për punëtorët në sektorin privat. Në këtë mënyrë mundet të zhvillohen edhe komunitetet edhe ekonomia e shtetit, pra të jepet kontribut fitimprurës i ndërsjellë.

8 Përfundim dhe rekomandime

Kuota për punësimin e komuniteteve si masë për sigurimin e përfshirjes së barabartë të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, e që janë të njohura nga Kushtetuta e vendit, ka zbatim shumë të vogël. Faktorët për një gjendje të tillë janë të shumtë dhe të ndryshëm duke filluar nga: 1) Mungesa e zhvillimit ekonomik dhe gjendja e përgjithshme e papunësisë në vend, 2) Mbingarkesa në administratën e vendit, 3) Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, 4) Politizimi i punësimin, 5) Mungesa e profilizimit të kuadrove, me theks të veçantë tek grup moshat mbi 30 vjeç, 6) Shpërqendrimi i fokusit të politikanëve nga detyra e përmbushjes së kërkesave, nevojave që rrjedhin nga qytetarët prandaj rekomandohet që:

- 1) Të merret iniciativë për ndryshimin e kriterëve të skemës sociale.
 - a) Zgjatja e moshës së fëmijës, si kriter për përfitimin e skemës sociale.
 - b) Të ngritet shuma e skemës sociale, e kombinuar me punën në të mirë publike me orë të kufizuara të angazhimit. Një praktikë e tillë do të ndikonte në krijimin e përvojës të punës për përfituesit dhe do të rriste potencialin që përfituesit e kësaj skeme të punësohen.
- 2) Të krijohen kushte më të mira për punësim përmes dhënies së numrit më të madh të granteve të ndryshme, trajnimit në punë dhe subvencionimit të pagës.
- 3) Ngritja e kërkesës së cilësisë së zbatimit cilësor të Masave Aktive të Tregut të Punës.
 - a) Kushtëzim i punëdhënësve me mbajtjen e punëtorëve nga radhët e komuniteteve për afatin e njëjtë kohor për të cilin u është subvencionuar paga.
 - b) Lirimi nga tatimi për bizneset të cilat pranojnë të punësojnë punëtorë që vijnë nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane.
- 4) Gjositje e përfituesit të Masave Aktive të Tregut të Punës, punëdhënësit dhe punëmarrësit në rast të evidentimit të marrëveshjes për marrje të mjeteve nga Masa dhe mos pranishëni punë tek biznesi i zgjedhur.
- 5) Iniciimi i kërkesës nga Këshilli konsultativ për komunitete për nxjerrjen e udhëzimit plotësues nga Kryeministri apo Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal për zbatimin e kuotës prej 10% , respektivisht balancimit të përfaqësimit të komuniteteve në konkurset e ardhshme.
- 6) Të ndryshohet ligji për përfaqësim politik në nivel komunal, jo të mbetet 10% të komuniteteve në raport me shumicëne asaj komune, por të marrë të drejtën për përfaqësim politik komuniteti i cili sipas numrit rangohen si komuniteti i dytë me radhë në komunë.

- 7) Të gjenden forma për punësim të pjesëtarëve të komuniteteve në drejtoritë komunale, të paktën në ato të fushave që janë të shënjestruara me Strategji (punë dhe mirëqenie sociale, arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë). Punësimi i pjesëtarëve të komuniteteve në këtasektorë do të ishte një kthim i besimit të tyre në institucionedhe hap drejt sigurimit të qasjes së barabartë dhe padallime në të mirat publike.
- 8) Të avokohet me urgjencë për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rome,ashkali dhe egjiptiane në shërbimet e sigurisë në vend, p.sh. Policinë e Kosovës.
Pjesëmarrja e ulët e pjesëtarëve të komuniteteve në Policinë e Kosovësparaqet një tregues i cili flet se institucionet dhe udhëheqësit e tyre nuk e kanë menduar përfshirjen e këtyre tri komuniteteve si komponentë domethënëse e cila kontribuon nëmirëmbajtjen e sigurisë dhe rendit në vend.
- 9) Ofrimi i mundësive për punën praktike në institucione lokale dhe ato qendrore: Komunë, shkolla, spitale e qendra mjekësore.
- 10)Avokimi i iniciuar nga shoqëria civile për përfshirjen e këshilltarëve të punësimin në Zyrat rajonale të punësimin sikurse që është i paraparë me Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve në shoqërinë kosovare 2017/2021.
Në mënyrë që të sigurohet paanshmëri në këtë proces, duhet të arrihet marrëveshje e rrjetit të organizatave të projektit KOSINT2020 në bashkëpunim me Zyrën për qeverisje të mirë dhe Agjencinë e Punësimin të Republikës së Kosovës.
- 11) Të ngritët vetëdija dhe angazhimi i komuniteteve për ndryshimin e gjendjes së tyre në fushën e zhvillimit ekonomik, arsimor, politik.
- 12)Zhvillimi i politikave të zbatueshme të cilat kanë në shënjestër zhvillimin e komuniteteve në premisat ekonomike të qëndrueshme.
- 13)Të përkrahen organizatat me bazë në komunitetet në ngritjen e kapaciteteve të tyre për ndërmjetësim të komuniteteve në punësim (veçanërisht në komunat ku mungon përfaqësimi i tyre në shërbimin civil dhe atë politik).
- 14)Të përkrahet ngritja e kuadrove, të rinj e të reja që vijnë nga këto komunitete të ngritin përvojën dhe profesionalizmin e tyre duke i përfshirë në punë menaxheriale, përmbajtjesore dhe të dukshme (me vizibilitet) për grupe të ndryshme të interesit.
- 15)Promovimi dhe stimulimi i rasteve të suksesit të punësimin të pjesëtarëve të komuniteteve. Një veprim i tillë do të ndikonte në ndryshimin e imazhit

dhe thyerjen e paragjykimeve që biznesi dhe komuniteti i gjerë mund të ketë për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane.

- 16) Promovimi i bizneseve të komuniteteve në projekte të ndryshme që shënjestrojnë fuqizimin ekonomik të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane.
- 17) Përmirësimi i kushteve të punës në sektorin privat, ofrimi i sigurimeve shëndetësore, kontrole mbi rregullimin e kontratave dhe posedimit të pajisjeve për punë. Ngritja e kontroleve nga inspektorati i punës, veçanërisht në vend punishtet e ndërtimtarisë.



ROMA INTEGRATION 2020
Regional Cooperation Council

RAPORT TEMATIK

RESPEKTIMI I KUOTËS SË PUNËSIMIT TË PJESËTARËVE
TË KOMUNITETEVE ROME, ASHKALI DHE EGJIPTIANE
NË INSTITUCIONE PUBLIKE

